Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0051

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së (OE) "Gazmend Bojku" B.I., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të "Kompania Ujësjellësi Rajonal Prishtina" SH.A. në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi me eskavator, kamioneta dhe rimorkio për bartje të eskavatorit" me numër të prokurimit 70433736-23-10741-1-1-1, me 02/04/2024, mori:

Vendim

1. **Aprovohet**, si e bazuar ankesa e OE "Gazmend Bojku" B.I., me nr. 2024/0051, e datës 15/01/2024, kurse vendimi i AK "Kompania Ujësjellësi Rajonal Prishtina" SH.A lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi me eskavator, kamioneta dhe rimorkio për bartje të eskavatorit" me numër të prokurimit 70433736-23-10741-1-1-1.

2. **Anulohet** njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi me eskavator, kamioneta dhe rimorkio për bartje të eskavatorit" me nr. të prokurimit: 70433736-23-10741-1-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – "Kompania Ujësjellësi Rajonal Prishtina" SH.A, dhe lënda kthehet në **Rivlerësim.**

3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.

4. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale --

Me 09.10.2023, "Kompania Ujësjellësi Rajonal Prishtina" SH.A në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me "Furnizimi me eskavator, kamioneta dhe rimorkio për bartje të eskavatorit" me nr. të prokurimit: 70433736-23-10741-1-1-1. Ndërsa me datën 20.12.2023 ka publikuar njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës punë dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 250,000.00 €..

Me 26.12.2023, OE "Gazmend Bojku" B.I., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 05.01.2024, Autoriteti Kontraktues e ka cilësuar si të pa bazuar.

Me 15.01.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE "Gazmend Bojku" B.I., me nr. 2024/0051 për lidhur me aktivitetin "Furnizimi me eskavator, kamioneta dhe rimorkio për bartje të eskavatorit" me nr. të prokurimit: 70433736-23-10741-1-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Gazmend Bojku" B.I., janë parashtruar si në vijim: Pretendimet e OE ankues: "Data e njoftimit për kontratë është bërë me dt.10.10.2023, kurse hapja e ofertave është bërë me dt. 27.11.2023.Njoftimi mbi vendimin e AK-së ishte bërë me dt. 20.12.2023 ku është rekomanduar për kontratë për pjesën 1 OE "Segment Kosova SHPK" me çmim prej: 104,897.69 €, ndërsa ne jemi shpallur si tenderues i pasuksesshëm. Ne kemi pasur qasje në dokumentacion të OE të rekomanduar për kontratë, ndërsa gjatë analizimit të dokumentacionit të OE të rekomanduar për kontratë kemi vërejtur se ky OE është i

papërgjegjshëm për arsyet që do ti elaborojmë më poshtë.

1.OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar një dokument deklaratë e emërtuar "Manufacturer Declaration" e lëshuar nga CASE CONSTRUCTION për SEGMENT SHA. Kjo Deklaratë nuk është e ditur se për cilin tender është e lëshuar pasi që kjo deklaratë nuk përmban titullin e tenderit e as numrin e prokurimit, prandaj nuk duhet të merret parasysh fare. Shih më poshtë deklaratën në fjalë: Kjo deklarate shihet se nuk është nga prodhuesi por nga ndonjë distributor (edhe pse nuk ka detaje), prandaj deklarata nga Export sales nuk ka kurrfarë kuptimi ku qarte shihen përgjigjet diplomatike të paqarta e mashtruese.

OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar edhe një dëshmi tjetër titulluar Declaration të lëshuar nga Segment SH.A-Kashar drejtuar KRU Prishtina e ku shënon se gjatësia e makinës është min:5600 mm(+-10%), ndërsa tek deklarata e CASE shkruan minimum 5600mm. Nga këto dy deklarata kuptohen qartë kundërthëniet e dy kompanive, madje kuptohet qartë mospërputhja e deklaratës së CASE sa i përket gjatësisë së makinës në raport me specifikimet teknike. Për më tepër rezulton se është ofertuar me variante edhe pse variantet nuk janë autorizuar në dosje të tenderit. Segment SH. A-Kashar ka bashkangjitur një marrëveshje me kompaninë CNHI Industrial kinse si prodhues kurse Segment SH.A-Kashar si distributor, ndërsa Segment SH.A - Kashar ka autorizuar Segment Kosova SHPK për këtë tender.

2. Në lidhje me shpenzimet e karburantit, kemi kërkuar nga autoriteti kontraktues që për pozicionin 11 të jepen informata dhe sqarime të sakta për pajisjen në fjalë CASE 590SV, e jo siç kanë dhënë deklarata mashtruese.(shiko me poshtë)

3. Po ashtu kemi kërkuar nga AK te konfirmon për pozicionin 34. Këtë deklarate te konformitetit e ka dhënë Segment Sh.A. Shqipëri e jo OE Segment Kosova Shpk e cila normalisht është dashur ta jep deklaratën për CE sepse Segment Kosova Sh.a është ofertuese në këtë tender.

4. Deklaratën mbi specifikacione teknike e dorëzuar nga OE Segmenti Shpk është e pa mbështetur në dokumente konkrete, sepse specifikat teknike duhet të jenë te sakta/specifikuara në bazë të specifikave teknike të eskavatorit CASE 590SV e jo siç kanë deklaruar me min ose max, e ku këto specifika janë marr nga dosja e tenderit - Annex 1. Duke pasur parasysh të gjitha këto dëshmi është e habitshme se si komisioni i vlerësimit ka rekomanduar për kontratë këtë operator ekonomik. Me gjithë këto shkelje kuptohet qartë se janë bërë keqpërdorime të detyrës zyrtare nga ana e komisionit në fjalë, e të cilat keqpërdorime dhe favorizime do ti denoncojmë në organet kompetente.

OE “Kosova Motors” është i papërgjegjshëm me arsyet si në vijim:

1.OE “Kosova Motors” është vetëm bashkëpunëtor i TERRA JASKA DOO, prandaj kemi kërkuar që autorizimi duhet të verifikohet se a është valid dhe origjinal.

Për pozicionin Nr.20 ka mospërputhje ndërmjet katalogut dhe deklaratave të këtij operatori ekonomik. Sipas deklaratës thellësia e gërmimit (teleskopi i zgjatur) është 5970mm, kurse ne katalog te ekskavatorit te ofertuar JCB 3CX Eco, ky pozicion është e cekur 5460mm. Edhe në këtë rast mund të themi lirisht se edhe ky OE ka ofertuar me variante në kundërshtim me kërkesat dhe specifikimet e dosjes së tenderit.

Duke pasur parasysh këto dëshmi, kemi kërkuar nga AK te konfirmon se me cilën eskavator OE ka ofertuar, sepse ne katalogat e prezantuara diku i ka nënvizuar specifikat te modelit 3CX ECO e disa specifika te modeli te tjera si 4CX PRO dhe 5CX PRO, mirëpo nuk kemi marr përgjigje konkrete.

3.Pozicionet 9, 11, 12, 13 dhe 14 nuk gjinden ne katalogun e ofruar nga OE Kosova Motors.

Përderisa nuk gjinden në katalog këto pozicione me parametra të kërkuar atëherë ky OE është i papërgjegjshëm dhe duhet të eliminohet nga konkurrenca.

Ne kemi kërkuar nga prodhuesi qe ta konfirmoj se për pozicionet e larte cekura a plotësohen specifikimet teknike dhe janë sipas dosjes së tenderit.

Në këto raste duhet të kërkohen drejtpërdrejtë sqarime nga prodhuesi se a i plotëson dimensionet sipas pozicioneve të lartë cekura sepse nuk mjafton vetëm deklarata e OE sepse ky është vetëm shitës e jo prodhues siç është kërkesa e dosjes së tenderit

OE Kosova Motors ka ofertuar me modelin 3CX ECO ku për pozicionin 14 e ka nënvizuar modelin 4CX PRO dhe 5CX PRO ku është nënvizuar Autoshift, prandaj edhe nga ky fakt kuptohet papërgjegjshmëria e këtij Operatori ekonomik sepse ka mospërputhje të mëdha s ai përket modelit dhe nënvizimit të modeleve.

4.Deklarata e specifikimeve teknike është e nënshkruar dhe vulosur nga vete ofertuesi Kosova Motors, ndërsa do te duhej te jete e nënshkruar dhe vulosur nga prodhuesi, pasi që prodhuesi duhet të jep garancionin për specifikime teknike.

5.Për pozicionet 34, 35 dhe 36 nuk janë dhënë deklarata me shkrim nga OE Kosova Motors, prandaj ky OE është i papërgjegjshëm. (Shih më poshtë)

Për pozicionet e lartë cekura janë te deklaruar vetëm tek specifikimet teknike por nuk janë dhënë deklarata me shkrim siç është kërkesë obligative e dosjes së tenderit.

6.OE Kosova Motors me dosje ka bashkangjitur autorizimin nga prodhuesi si më poshtë: Ky autorizim është shumë konfuz dhe i paqartë sepse prodhuesi në këtë rast deklaron se KMG Kosova LLC është partner i autorizuar i Terra Jaska doo qe është i vetmi distributor i autorizuar për shitje dhe servisim te makinave markës JCB ne Kosovë. Në këtë rast mungon marrëveshja dy paleshe në mes të prodhuesit dhe distributorit të autorizuar Terra Jaska doo e që do të tregonte që ekziston marrëveshje bashkëpunimi. Po ashtu mungon marrëveshja ne mes te Terra Jaska doo dhe KMG Kosova LLC. Deri sa mungojnë këto marrëveshje, nuk mund te vërtetohet se a janë vërtet bashkëpunëtor këto kompani. Po ashtu deri sa nuk dëshmohen këto marrëveshje dhe nuk ka vërtetësi të këtyre marrëveshjeve potenciale, atëherë prodhuesi në fjalë nuk mund ti jap autorizim dikujt e që më pastaj i njëjti të ja lëshoj autorizimin një kompanie tjetër, e që në këtë rast është OE KMG Kosova LLC.

Autoriteti kontraktues në vendimin e dt.05.01.2024 për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim nuk ka dhënë asnjë shpjegim e as argumentim përse nuk janë marr parasysh pretendimet tona ankimore, por vetëm ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim si të pabazuar. Në vendimin për refuzim autoriteti kontraktues është përgjigjur si në vijim:

Autoriteti kontraktues e ka cekur se i është drejtuar prodhuesve me email, mirëpo realisht nuk ka arrit të dëshmojë se prodhuesit janë përgjigjur në lidhje me specifikimet teknike të kërkuar në dosje të tenderit përkatësisht tek specifikimi teknik në aneksin Neve me dt.12.01.2024 na janë dërguar komunikimet që zyrtarët e AK-së kanë bërë kinse me prodhuesit.Autoriteti kontraktues me dt.29.12.2023 ka dërguar shkresë në emailin e mëposhtëm me kërkesën si në vijim:

Nga këto komunikime vërehet qartë manipulimi me emaila, sepse shkresa nga KRU Prishtina është drejtuar në emailin si në vijim: cnh.italia@pec.cnhind.com, kurse përgjigja është marr nga emaili: <ionut.roscoiu@cnhind.com>.

Edhe gjatë këtyre komunikimeve nuk kemi ndër lidhshmëri të fakteve me të cilat ka ofertuar OE i rekomanduar për kontratë dhe realisht nuk është ofruar asnjë dëshmi shtesë konkrete se deklarata është e prodhuesit dhe se përputhen specifikimet teknike të ofruara me specifikimet e përcaktuara në aneksin 1 të dosjes së tenderit. Ne dyshojmë që emaili i kthyer nga email adresa ionut.roscoiu@cnhind.com ka mund të kthehet nga ndonjë person jo kompetent apo thjesht ka mundur të keqpërdoret kjo adresë për të kthyer përgjigje siç i konvenon OE të rekomanduar për kontratë.

Tek specifikimi për gjatësinë, sqarimi është dhënë si në vijim:

Length of equipment is over requested “min. 5600 mm (+/- 10%)”, depending of type of fitted buckets.

Edhe nga ky sqarim kuptohet qartë se nuk është dhënë saktë dimensioni i pajisjes por vetëm është shënuar “min. 5600 mm (+/- 10%), ndërsa sqarimi duhet te jepet saktë për dimensionin e pajisjes e jo te manipulohet me (+/- 10%) sikurse në deklaratë.

Pra edhe me sqarime është lënë hapësira manipuluese për gjatësinë dhe nuk janë dhënë dimensionet e sakta, prandaj duhet eliminuar si i papërgjegjshëm ky OE.

Mospërputhjet përsëri vërehen edhe tek kërkesa për sqarime ku pyetja është bërë nga AK- së për lartësinë e hedhjes:

-throw height (load) is max 4700 mm;

Kurse përgjigja ka qenë si në vijim:

Throw height (load) is 5124 mm (“min 4700 mm” - in respect to final Corrected Technical Specifications).

Kjo përgjigje tregon se është dhënë sa për të thënë që përmbushet specifikimi teknik, mirëpo edhe po të ishte lëshuar emaili nga kompania prodhuese përgjegjëse, përsëri nuk duhet të merret parasysh sepse kemi ndryshim të specifikimeve teknike, dhe shihet qartë që thuhet: në lidhje me specifikimet teknike përfundimtare të korrigjuara. Pra konstatohet se janë korrigjuar specifikimet teknike. Ky është favorizim i hapur i kompanisë fituese, ndërsa diskriminohen kompanitë tjera, e ku ka kompani të tjera që për shkak të mos përmbushjes së një specifikimi teknik nuk kanë ofertuar në këtë tender. Pra pyetja ka qenë që a është lartësia e hedhjes max 4700 mm, kurse përgjigja është dhënë që është min 4700 mm në lidhje me specifikimet teknike përfundimtare të korrigjuara.

Edhe për OE Kosova Motors Group Shpk nuk është ofruar asnjë dëshmi konkrete se ky OE është i përgjegjshëm dhe në asnjë mënyrë nuk janë argumentuar e kundërta e pretendimeve tona ankimore.

Autoriteti kontraktues me rekomandimin për kontratë të OE “Segment Kosova SHPK”, ka vepruar në kundërshtim me nenin 59.4 të LPP-së, pasi që i njëjti nuk i plotëson kërkesat e dosjes së tenderit ashtu siç u cek më lartë, prandaj është i papërgjegjshëm.

Duke u referuar pretendimeve si më sipër “Gazmend Bojku” B.I., konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin Neni 1, 7, 52, 56, 59, 60, 69, 72 të LPP-së, si dhe nenin 38 dhe 40 i rregullores nr.001/2022 për prokurim publik. Duke propozuar qe të aprovohet, e bazuar ankesa e OE N.P.T “BOJKU HIDRAULIK, përpjesën te anulohet njoftimi

mbi vendimin e AK-së (B58) për dhënie të kontratës i datës 13.12.2023 për pjesën 1 dhe lënda të kthehet në RIVLERËSIM, ndërsa rivlerësimi i ofertave të bëhet sipas dispozitave ligjore të LPP-së dhe konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë. LEJOHET kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik "BOJKU HIDRAULIK.

Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim: "Pas kërkesës për rishqyrtim, e cila për shkak te festave te fund vitit ka marre shume kohe për rishqyrtim, ne menjëherë kemi pezulluar aktivitetin dhe pas kësaj , komisioni i vlerësimit , ne përputhje ne pretendimin e juaj u është drejtuar prodhuesve me kërkesat, ne mënyrë qe ata te deklarohen rreth përputhshmërisë se ofertës përkatëse ne raport me specifikimin teknik te kërkuar ne Aneksin 1 te D.T. Deklaratat për përputhshmëri te specifikimit teknik janë dorëzuar si ne vijim:

Segment Kosova SH.P.K.-Rreth kësaj kërkese kemi pranuar Deklarate rreth përputhshmërisë se specifikave teknike përmes zyrës se autorizuar (shiko bashkangjitur Deklaratën e cila është përsëritje e asaj qe është dorëzuar ne oferte)

KOSOVA MOTORS GROUP S H.P.K.-Edhe prodhuesi (JCB) për këtë O.E., ka dërguar Deklarate rreth përputhshmërisë se specifikave teknike përmes zyrës se autorizuar (shiko bashkangjitur Deklaratën e cila është përsëritje e asaj qe është dorëzuar ne oferte)

Gazmend Bojku B.l.-Edhe prodhuesi (ÇUKUROVA) për këtë O.E., ka dërguar Deklarate rreth përputhshmërisë se specifikave teknike përmes zyrës se autorizuar (shiko bashkangjitur Deklaratën e cila është përsëritje e asaj qe është dorëzuar ne oferte) Duke pasur parasysh këtë qe u cek me lart, Autoriteti Kontraktues konsideron këtë Kërkesë Për Ri- Shqyrtim Si Te Pa-Bazuar."

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 17.01.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0051/24, ndërsa me datë 29.01.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/0051 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk Pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtuese, ndërsa OE pajtohet lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE "Gazmend Bojku" B.I.- eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/0051 ka vlerësuar si në vijim:

Sqarim hyrës: "Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues i pakënaqur me vendimin e AK-se, konform nenit 108/A ka parashtruar ankese ne OSHP, me pretendimin se autoriteti kontaktues – KOMPANIA UJËSJELLËSI RAJONAL PRISHTINA SH.A, nuk i ka respektuar dispozitat e LPP-se, kryesisht nenin 59 të LPP-se, me këtë rast ka rekomanduar për kontrate një operatore ekonomik i cili nuk i plotëson kriteret e dosjes se tenderit. Autoriteti Kontaktues –Kompania Ujësjellësi Rajonal Prishtina SH.A, me datën 20.12.2023 ka publikuar njoftimin B46 - Letër standarde për tenderuesin e pasuksesshëm. OE ankues N.P.T "BOJKU HIDRAULIK" me datën: 26.12.2023 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim ndërsa AK-ja me datën 05.01.2024 refuzon kërkesën e OE ankues si të pabazuar."

Pretendimi nr.1: "Kjo deklarate shihet se nuk është nga prodhuesi por nga ndonjë distributor (edhe pse nuk ka detaje), prandaj deklarata nga Export sales nuk ka kurrfarë kuptimi ku qarte shihen përgjigjet diplomatike të paqarta e mashtruese. 5/6 OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar edhe një dëshmi tjetër titulluar Declaration të lëshuar nga Segment SH.A-Kashar drejtuar KRU Prishtina e ku shënon se gjatësia e makinës është min:5600 mm(+-10%), ndërsa tek deklarata e CASE shkruan minimum 5600mm. Nga këto dy deklarata kuptohen qartë kundërthëniet e dy kompanive, madje kuptohet qartë mospërputhja e deklaratës së CASE sa i përket gjatësisë së makinës në raport me specifikimet teknike. Për më tepër rezulton se është ofertuar me variante edhe pse variantet nuk janë autorizuar në dosje të tenderit. Segment SH. A-Kashar ka bashkangjitur një marrëveshje me kompaninë CNHI Industrial kinse si prodhues kurse

Segment SH.A-Kashar si distributor, ndërsa Segment SH.A -Kashar ka autorizuar Segment Kosova SHPK për këtë tender. Përderisa kanë ekzistuar të gjitha këto kundërthënie dhe paqartësi në deklarata dhe dokumente, ne me kërkesë për rishqyrtim kemi kërkuar nga AK që kjo deklaratë të verifikohet direkt tek prodhuesi dhe të pyetet prodhuesi se sa është gjatësia e saktë, e eskavatorit CASE 590SV Kërkesa tek specifikimet teknike është si më poshtë:

OE fitues ka deklaruar se do ti përmbushë specifikimet teknike te dosjes se tenderit ne Aneksin 1, respektivisht pozicionin 17. Gjatësia minimum 5600 mm (+, - 10%) dhe siç shihet ne deklaratën e prodhuesit gjatësia është minimum 5600mm, funksioni varijon nga lloji i luges(koves) se montuar, kriter i cili është i përshtatshëm me kërkesat teknike.

Ekspertja teknike ka bere një hulumtim ne internet dhe ne likun https://www.lectura-specs.com/en/model/construction-machinery/backhoe-loaders-case/590sv-11749434, ka gjetur se gjatësia është 5560mm, ne përputhje me devijimin e lejuar (+,-10%), andaj pretendimi ankimore është i pa bazuar.

Pretendimi nr.2: “Në lidhje me shpenzimet e karburantit, kemi kërkuar nga autoriteti kontraktues që për pozicionin 11 të jepen informata dhe sqarime të sakta për pajisjen në fjalë CASE 590SV, e jo siç kanë dhënë deklarata mashtruese. (shiko me poshtë)

Ekspertja teknike konstaton se gjatë pyetjeve të pranuara nga OE-të për këtë pozicion, përgjigja e AK ka qene "Kemi kërkuar makineri – eskavator që shpenzimet e karburantit t’i ketë sa më të vogla të mundshme. Kjo për arsye se ndër të tjera e kemi prioritet uljen e shpenzimeve, prandaj të gjithë prodhuesit në katalogjet e tyre i cekin edhe shpenzimet e lëndës djegëse dhe ne e kemi vlerësuar që shpenzimet e eskavatorit bazuar në katalogët e prodhuesve mos ta kalojnë specifikën e kërkuar në Dokumentacionin e dosjes së tenderit", ndërsa ne katallogun e OE fitues gjendet fjalia " + NEW ECO mode is standard on all units and delivers 10% fuel consumption saving+ Environmentally friendly!! ", e cila nuk korrenspodon me kërkesën e specifikacionit teknik për shpenzimet e karburantit për ore pune max 10 l/h, andaj pretendimi ankimore është i bazuar”.

Pretendimi nr.3: “OE “Kosova Motors” është i papërgjegjshëm me arsyet si në vijim: 1. OE “Kosova Motors” është vetëm bashkëpunëtor i TERRA JASKA DOO, prandaj kemi kërkuar që autorizimi duhet të verifikohet se a është valid dhe origjinal. 2. Për pozicionin Nr.20 ka mospërputhje ndërmjet katalogut dhe deklaratave të këtij operatori ekonomik. Sipas deklaratës thellësia e gërmimit (teleskopi i zgjatur) është 5970mm, kurse ne katalog te ekskavatorit te

ofertuar JCB 3CX Eco, ky pozicion është e cekur 5460mm.

Ekspertja teknike konstaton se ka verifikuar fq.7 te katallogut dhe pretendimi ankimore i juaji është i pa bazuar sepse është marre SAE max dig depth 5460 mm, ndërsa behet fjale për Maximum dig depth with deep profile bucket 5970 mm. Ndërsa pretendimi tjetër ankimore se ka nënvizuar specifikat e modeleve tjera si 4CXPRO dhe 5CXPRO është i bazuar sepse ka nënvizuar specifikat e transmisionit për modelet 4-5 CXPRO dhe mund te vërtetohet ne fq.3 te katalogut."

Pretendimi nr.4: "Pozicionet 9, 11, 12, 13 dhe 14 nuk gjinden ne katalogun e ofruar nga OE Kosova Motors. 7/6 Përderisa nuk gjinden në katalog këto pozicione me parametra të kërkuar atëherë ky OE është i papërgjegjshëm dhe duhet të eliminohet nga konkurrenca. Ne kemi kërkuar nga prodhuesi që ta konfirmoj se për pozicionet e lartë cekura a plotësohen specifikimet teknike dhe janë sipas dosjes së tenderit. Në këto raste duhet të kërkohen drejtpërdrejtë sqarime nga prodhuesi se a i plotëson dimensionet sipas pozicioneve të lartë cekura sepse nuk mjafton vetëm deklarata e OE sepse ky është vetëm shitës e jo prodhues siç është kërkesa e dosjes së tenderit.

Ekspertja teknike konstaton se pretendimi ankimore **është i bazuar**, pasi që për modelin 3CX ECO STAGE V nuk janë te nënvizuara dhe nuk gjinden ne katalog."

Pretendimi nr.5: "Length of equipment is over requested "min. 5600 mm (+/- 10%)", depending of type of fitted buckets. Edhe nga ky sqarim kuptohet qartë se nuk është dhënë saktë dimensioni i pajisjes por vetëm është shënuar "min. 5600 mm (+/- 10%), ndërsa sqarimi duhet te jepet saktë për dimensionin e pajisjes e jo te manipulohet me (+/- 10%) sikurse në deklaratë. Pra edhe me sqarime është lënë hapësira manipuluese për gjatësinë dhe nuk janë dhënë dimensionet e sakta, prandaj duhet eliminuar si i papërgjegjshëm ky OE.

Ekspertja teknike ka te njëjtën përgjigje sikur pretendimi ankimore nr.1 i ngjashëm me këtë, dhe si përfundim pretendimi ankimore është i pa bazuar".

Pretendimi nr.6: "Mospërputhjet përsëri vërehen edhe tek kërkesa për sqarime ku pyetja është bërë nga AK-së për lartësinë e hedhjes: -throw height (load) is max 4700 mm; Kurse përgjigja ka qenë si në vijim: Throw height (load) is 5124 mm ("min 4700 mm" – in respect to final Corrected Technical Specifications).

Ekspertja teknike konstaton se pretendimi ankimore është i pa bazuar dhe mund të vërtetohet ne fq.14 nga katallogu ku thuhet: Maximum loading height 5124 mm, ne përputhje me kërkesën min 4700 mm. Eksperti shqyrtues, sqaron se përgjigjet ne pretendime ankimore janë dhënë nga eksperti teknik."

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Gazmend Bojku" B.I. Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtuese është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit/teknik mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertëve shqyrtues profesional dhe teknik. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Gazmend Bojku" B.I., janë të bazuara.

- *Gjetjet e Panelit Shqyrtues* –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e "Furnizimi me eskavator, kamioneta dhe rimorkio për bartje të eskavatorit" me nr. të prokurimit: 70433736-23-10741-1-1-1. Paneli shqyrtues vlerëson se eksperti shqyrtues/teknik i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Gazmend Bojku" B.I. dhe se argumentimi në raportin e ekspertit është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Andaj, Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit dhe pa nevoj që të njëjtat të përsëriten prapë. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Gazmend Bojku" B.I. janë të bazuara.

Paneli Shqyrtues duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartë përmendura dhe pas shqyrtimit të lëndës, ankesën e operatorit ekonomik ankues, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës, ankesën e operatorit e sheh si të bazuar, dhe konstatimet e ekspertëve atëherë e mbështet edhe rekomandimin që aktiviteti i prokurimit me "Furnizimi me eskavator, kamioneta dhe rimorkio për bartje të eskavatorit" me

nr. të prokurimit: 70433736-23-10741-1-1-1 të kthehet në rivlerësim dhe AK në kuptim të nenit 59.2 dhe nenit 72 të LPP të sqaroj këto pretendime dhe dyshime të ngritura dhe konstatime të ekspertëve shqyrtues. Po ashtu, nëse është e nevojshme të vë në zbatim edhe neni 52.7 të LPP.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në ketë rast përbëjnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim.

Panelit Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën IV të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KOMPANIA UJËSJELLËSI RAJONAL PRISHTINA SH.A.**
- OE - **Gazmend Bojku B.I.**
- Arkivës së OSHP-së: